



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 131
Prishtinë, më 7 tetor 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 7 TETOR 2010**

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 23 dhe 30 shtator 2010,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-037 për dokumentet e udhëtimit,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasje në dokumente publike,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë elektrike,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Naim Rrustemi, Lulëzim Zeneli, Riza Smaka, Ismajl Kurteshi, Fatmir Rexhepi, Bahri Hyseni, Berim Ramosaj, Emrush Xhemajli, Driton Tali, Gani Buçinca dhe Gjylnaze Sylja, që janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, **kryesuesi** konstatoi se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë.

Ai e njoftoi Kuvendin se në ndërkohë deputeti Driton Tali, i përkrahur edhe nga pesë deputetë të tjerë, ka parashtruar kërkesë me shkrim për radhitje në rendin e ditës së mbledhjes së sotme plenare - Debat për garancionin bankar të operatorit mobil “Kosmocell”.

Kryesuesi propozoi që kjo kërkesë e deputetit Tali, fillimisht të shqyrtohet në Kryesinë e Kuvendit dhe të procedohet më tutje.

Kuvendi miratoi propozimin e kryesuesit, Haliti.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Gjylnaze Sylja**, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me rritjen e pagave të mësimitdhënësve.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Sylja.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtroi pyetje për ministrin Haki Demolli lidhur me veprimet e mundshme të Ministrisë që ai drejton për përfilljen e dispozitës së nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ministri **Haki Demolli** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Arsim Bajrami**, parashtroi pyetje për ministren Edita Tahiri lidhur me procedimin në Kuvend të Projektligjit për Qeverinë.

Ministrja **Edita Tahiri** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bajrami.

Deputetja **Drita Maliqi**, parashtroi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj lidhur me pajisjen e nxënësve të shkollave fillore me tekste shkollore.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputeti **Ramadan Gashi**, parashtroi pyetje për ministrin Bujar Bukoshi lidhur me shërbimet e ofruara në spitalin regjional të Mitrovicës.

Ministri Bukoshi nuk ishte i pranishëm.

Deputeti **Naim Rrustemi**, parashtroi pyetje për ministrin Bujar Bukoshi lidhur me dëmtimin e buxhetit të Kosovës gjatë blerjes së barnave.

Ministri Bukoshi nuk ishte i pranishëm.

Deputeti **Driton Tali**, parashtroi pyetje për ministrin Bujar Bukoshi lidhur me personat publik të cilët shpronësuan pronën e QKUK-së.

Ministri Bukoshi nuk ishte i pranishëm.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me politikat qeveritare në raport me dëmet njerëzore dhe materiale që Serbia ka shkaktuar në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999.

Kryeministri Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Deputetja **Teuta Hadri**, parashtroi pyetje për ministrin Skender Hyseni lidhur me pajisjen e përfaqësuesve diplomatikë të Republikës së Kosovës me vetura zyrtare.

Ministri Hyseni nuk ishte i pranishëm.

Deputeti **Driton Tali**, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi ose ministrin Ahmet Shala lidhur me ndaljen e kontrabandës me derivate në Mitrovicë.

Kryeministri Thaçi dhe ministri Shala nuk ishin të pranishëm.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 23 dhe 30 shtator 2010

Procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 23 dhe 30 shtator 2010, u miratuan pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-037 për dokumentet e udhëtimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-037 për dokumentet e udhëtimit.

Raportin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri – komision raportues, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Rustem Mustafa.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Mustafa, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 8.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr.6.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-037 për dokumentet e udhëtimit.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasje në dokumente publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për qasje në dokumente publike.

Raportin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media– komision raportues, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Esat Brajshori.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Brajshori, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 dhe 26

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për qasje në dokumente publike.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë Transport dhe Telekomunikacion – komision raportues, e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Myzejene Selmani.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e znj. Selmani, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37 dhe 38.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----66,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për energjinë.

Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë Transport dhe Telekomunikacion – komision raportues, e arsyetoi anëtar i këtij komisioni, Et'hëm Çeku.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Çeku, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për energjinë.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë elektrike

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për energjinë elektrike.

Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë Transport dhe Telekomunikacion – komision raportues, e arsyetoi anëtar i këtij komisioni, Et'hëm Çeku.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Çeku, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për energjinë elektrike.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë Transport dhe Telekomunikacion – komision raportues, e arsyetoi anëtar i këtij komisioni, Et'hem Çeku.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Çeku, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 44.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa – komision raportues, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Gani Koci.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Koci, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa – komision raportues, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Gani Koci.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Koci, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit funksional raportues për Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Raportin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media– komision raportues, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Esat Brajshori.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Brajshori, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 a), 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:33 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale